

Fillimi > KRONIKË

## Vrau babë e bir, publikohet momenti i arrestimit të ish-dhëndrit. RENEA i jep fund arratisë së 49-vjeçarit

16 Dhjetor, 2022 11:17



Madhësia e tekstit: ( - )

Publikohet momenti i arrestimit të Besnik Pjetrit, që vrau babë e bir në Lezhë në gusht të këtij viti. 49-vjeçari u arrestua nga RENEA, pasi ishte në arrati prej disa muajsh.

Besnik Pjetri qëlloi për vdekje me armë Pjeter dhe Gent Perjakun, teksa këta të fundit ndodheshin në banesën e tyre dhe sapo ishin kthyer nga Italia.

Krimi i rëndë dyshohet se si motiv ka pasur konfliktet e vazhdueshme pas divorcit për një shumë parash mes autorit dhe vajzës e viktimës.

Autori kishte dy fëmijë nga martesë me vajzën e viktimës, ndërsa jetonin më herët në Itali. Ata thuhet se vazhdimisht kanë pasur konflikte me njëri-tjetrin, për çështje ekonomike që çoi dhe në vrasjen e dyfishë.

### NJOFTIMI I POLICISE

RENEA kap dhe vë në pranga një shtetas shumë të kërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri. Finalizohet operacioni policor i koduar "Fundi i arratisë", i zhvilluar në kushte të vështira terreni dhe atmosferike. Operacioni, i finalizuar si rezultat i ndërhyrjes profesionale të shërbimeve të RENEA-s dhe punës gjurmuese-policore të strukturave hetimore dhe operacionale të Policisë së Lezhës.

Lokalizohet në një banesë të braktisur në Kaçinar, Mirditë, kapet dhe vihet në pranga 49-vjeçari i shumëkërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri. I ndaluar vrau babanë dhe vëllanë e ish-bashkëshortes së tij, më datë 29.08.2022, në banesën e tyre, në Grykë-Zezë, Lezhë.

Shërbimet e Policisë së Lezhës, në vijim të punës intensive gjurmuese-policore, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për kapjen dhe vënien në pranga të autorit të shumëkërkuar të vrasjes së dyfishtë, me armë zjarri, të ndodhur më 29.08.2022, në Grykë-Zezë, Lezhë, ku u vranë shtetasit P. P., 56 vjeç dhe G. P., 52 vjeç (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së autorit), mbështetur nga inteligjencia informative, si dhe falë ndërhyrjes profesionale nga shërbimet e RENEA-s, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Fundi i arratisë", të zhvilluar në një terren me kushte tejet të vështira gjeografike dhe atmosferike.

Si rezultat i këtij operacioni, falë kërkimeve të pandërprera dhe ndjekjes intensive, duke përdorur formë dhe teknika speciale hetimi, u bë i mundur lokalizimi në një banesë të braktisur, në fshatin Kaçinar, Mirditë, si dhe kapja e vëllai në pranga e shtetasit:

– B. P. (P.), 49 vjeç, banues në Troshan, Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë i ka caktuar 49-vjeçarit, në mungesë, masën e sigurisë "Arrest në burg", pasi nga veprimet hetimore, të kryera nën drejtimin e Prokurorisë së Lezhës, rezultojn se 49-vjeçari, më datë 29.08.2022, për shkak të një konflikti me familjarët e ish-bashkëshortes së tij, ka vrarë me armë zjarri shtetasit P. P. dhe G. P. (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së tij).


Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)


Etiketa: Besnik Pjetri

### TËNGJASHME



Vrau ish-vjehrin dhe ish-kunatin në Lezhë, arrestohet pas disa muajsh në arrati Besnik Pjetri

16 Dhjetor, 2022



FOTO/ Ky është 49-vjeçari nga Lezha që ekzekutoi ish-vjehrin dhe ish-kunatin, policia ende në kërkim të tij

30 Gusht, 2022



Unsold 2020 SUVs In Kashar Are Almost Being Given Away

90% discount is available for this month (More Details)

Unsold SUV | Search AD | Sponsored

Search Now



The Cost Of IVF Treatments In Mexico Might Totally Surprise You!

Fertility Clinics | Search Ads | Sponsored



Ndërron jetë ish-ministri, mesazhi i ndjerë i Lindita Nikollës: U nda para kohe nga jeta eksperti i shquar dhe njeriu i mirë

Ndërron jetë ish-ministri, mesazhi i ndjerë i Lindita Nikollës: U nda para kohe nga jeta eksperti i shquar dhe njeriu i mirë

balkanweb.com



Incredible: seniors are snapping up these new slippers, here's the reason!

OrthoCare | Sponsored

### TË FUNDIT NGA-KRONIKË



"Kush do jenë ata që do t'oni ku e kanë vendin për këto 30 vite?", anëtarja e KLP i kërkon emra kandidatit për kreun e SPAK, Xholi: Nëse një zyrtar i lartë...

16 Dhjetor, 2022



Çfarë ndodhi në ish-Bllok? E zbrisin nga makina dhe i vendosin prangat, momenti kur policia arreston një të ri në Tiranë

16 Dhjetor, 2022



Humbi jetën në aksidentin tragjik në Tiranë, zbardhet identiteti i viktimës (EMRI-FOTO)

16 Dhjetor, 2022



Gara për kreun e SPAK/ "Prokuroria ishte bërë si Big Brother", prokurori Xholi: Kam marrë në pyetje kryeministria, ministria e deputetë që s'kishin parë dyert e drejtësisë

16 Dhjetor, 2022



EMRI/ Shqiptari iu fut në banesë për ta grabitur, moshuari belg e plagos rëndë me armë


16 Dhjetor, 2022



Vuante nga një sëmundje e rëndë, ndahet nga jeta në moshë të re efektivi i FIVE

16 Dhjetor, 2022

### KATEGORIA VIDEO



Vrau babë e bir, publikohet momenti i arrestimit të ish-dhëndrit. RENEA i jep fund arratisë së 49-vjeçarit

16 Dhjetor, 2022



"Kush do jenë ata që do t'oni ku e kanë vendin për këto 30 vite?", anëtarja e KLP i kërkon emra kandidatit për kreun e SPAK, Xholi: Nëse një zyrtar i lartë...

16 Dhjetor, 2022



Çfarë ndodhi në ish-Bllok? E zbrisin nga makina dhe i vendosin prangat, momenti kur policia arreston një të ri në Tiranë

16 Dhjetor, 2022




Gara për kreun e SPAK/ "Prokuroria ishte bërë si Big Brother", prokurori Xholi: Kam marrë në pyetje kryeministria, ministria e deputetë që s'kishin parë dyert e drejtësisë

16 Dhjetor, 2022



Nga platforma, intervistimi dhe vetimi, nis gara për zgjedhjen e kreut të ri të SPAK. Mungon një anëtar i KLP. Të pranishëm në seancë përfaqësues të SHBA e Opdat

16 Dhjetor, 2022



Reforma në drejtësi/ Nga deklarata "pa SHBA nuk do ishte e mundur" te "nuk vendos ambasada", si ndryshoi Rama qëndrim për rolin e Amerikës, përplasja me Yuri Kim

16 Dhjetor, 2022